

VENDIM
Nr. 69, datë 12.3.2021

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “KROI MBRET ENERGJI” SHPK, PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 461/1, SERIA P20, MIRATUAR ME VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 41, DATË 6.3.2020, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC “BACKA 1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1600 kw, HEC
“BACKA 2” ME KAPACITET TË INSTALUAR 4000 kw, HEC “BACKA A” ME
KAPACITET TË INSTALUAR 500 kw, HEC “BACKA B”, ME KAPACITET TË
INSTALUAR 500 kw, HEC “BACKA C” ME KAPACITET TË INSTALUAR 720 kw, ME
KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 7320 kw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë Elektrike”, të ndryshuar; të nenit 10, pika 3 dhe të nenit 15, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 19, pika 1, germa “a” dhe 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 35/6 prot., datë 11.3.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 41, datë 6.3.2020, Bordi i ERE-s vendosi të licencojë shoqërinë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Backa 1”; me kapacitet të instaluar 1600 kw; “Backa 2” me kapacitet të instaluar 4000 kw, “Backa A” me kapacitet të instaluar 500 kw; “Backa B” me kapacitet të instaluar 500 kw dhe “Backa C” me kapacitet të instaluar 720 kw, me kapacitet total 7320 kw, për një afat 28 vjet e 5 muaj, me kusht që përpara fillimit të operimit të veprimtarisë, shoqëria të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor. Këto HEC-e ndodhen në lumin e Straveckës, rrethi i Skraparit.

- Shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., me shkresën nr. 51 prot., datë 5.3.2021, ka përcjellë në ERE kërkesën për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike.

- Kërkesa për modifikimin e licencës nr. 461/1, seria P20, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 41, datë 6.3.2020, sipërcituar, vjen për arsye se kanë ndodhur ndryshime në karakteristikat e HEC-eve, ku nga 5 (pesë) HEC-e do të jenë 3 (tri) HEC-e, konkretisht HEC Backa “1”, “A”, “C”.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 3059/4 prot., datë 18.6.2020, drejtuar shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k, për dijeni Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), ka miratuar projektin e zbatimit përfundimtar (të ndryshuar) të HEC “Backa 1”, “A”, “C”.

- Në vijim të sa më sipër, shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k. dhe MIE kanë lidhur kontratën shtesë të koncesionit me nr. 3889 rep., nr. 959 kol., datë 27.7.2020, “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (ndërtim - operim - transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B” dhe “Backa C”.

- Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton i plotësuar pjesërisht, si më poshtë:

Neni 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4, në rastin e modifikimit/ndryshimit të licencës me kërkesë të të licencuarit, ERE zbaton të njëjtat afate dhe procedura si për licencimin, duke kërkuar informacionin e mëposhtëm:

- germa “a”, një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës). Plotësuar;

- germa “c”, miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera. Plotësuar;

- germa “e”, të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE. Plotësuar.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

Formatin dhe dokumentacionin për aplikim:

- Neni 9, pika 1, germa “a” (të dhënat për aplikim), germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) dhe germa “c” (të dhëna për aplikuesin);

- Neni 15, pika 4:

- germa “b”, vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës;

- germa “d”, ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi, do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë ato brenda afateve që përcakton “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Gjithashtu në kuptim të nenit 11, pika 1, të “Rregullores së licencimit shoqërisë ‘Kroi Mbret Energji’ sh.p.k.”, do t’i kërkohet në vijim edhe informacion rreth vlefshmërisë së “Marrëveshjes për lidhje të re” që ka nënshkruar me OSHEE sh.a., në kuadër të ndryshimeve të karakteristikave të HEC, të cilat prekin kapacitetin total të instaluar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “Kroi Mbret Energji” sh.p.k., nr. 461/1, seria P20, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 41, datë 6.3.2020, për prodhimin e energjisë elektrike, për një afat 28 vjet e 5 muaj, me kusht që përpara fillimit të operimit të veprimtarisë, shoqëria të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor, në përputhje me parashikimet e kontratës shtesë të koncesionit nr. 3889 rep., nr. 959 kol., datë 27.7.2020, “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (ndërtim - operim - transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve ‘Backa 1’, ‘Backa 2’, ‘Backa A’, ‘Backa B’ dhe ‘Backa C’”, si më poshtë:

Ishte: HEC “Backa 1” me kapacitet të instaluar 1600 kw;

HEC “Backa 2” me kapacitet të instaluar 4000 kw;

HEC “Backa A” me kapacitet të instaluar 500 kw;

HEC “Backa B” me kapacitet të instaluar 500 kw;

HEC “Backa C” me kapacitet të instaluar 720 kw;

me kapacitet total 7320 kw.

Bëhet: HEC “Backa 1” me kapacitet të instaluar 3366 kw;

HEC “Backa A” me kapacitet të instaluar 1347 kw;

HEC “Backa C” me kapacitet të instaluar 1910 kw;

me kapacitet total 6623 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti